



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## AUTORITETI I KONKURENCËS

### Njoftim Paraprak Përqendrimi

**Rasti: Përfitim Kontrolli: Vestel Ticaret A.S / Compal Electronics Europe sp. Z.o.o.**

Në datën 10 Prill 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të “Marrëveshjes përfundimtare për blerjen e aksioneve”. Me anë të kësaj marrëveshje, të nënshkruar me datë 30 Dhjetor 2016, synohet të realizohet kalimi i drejtpërdrejtë i kontrollit të shoqërisë Compal Electronics Europe sp. Z.o.o. (“Target”) nga shoqëria Vestel Ticaret A.S (“Blerësi”).

Ky njoftim bëhet për shkak se Grupi Zorlu dhe Blerësi realizojnë shitje në Shqipëri dhe plotësohen kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Vestel Ticaret A.S:** është një shoqëri turke dhe aktiviteti kryesor i saj është import, eksport, tregtia kombëtare dhe ndërkombëtare, mirëmbajtje, shërbime dhe riparime të të gjitha pajisjeve elektronike, etj.. Shoqëria është pjesë e Grupit Zorlu.
- **Compal Electronics Europe sp. Z.o.o.:** është një shoqëri polakë e cila zotëron dhe operon një fabrikë të prodhimit të aparateve të TV. Ajo është pjesë e grupit Compalead i cili është aktiv në prodhimin e PC notebook PCs, produkteve LCD dhe pajisjeve smart, etj..

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me neni 10, pika 1, shkronja b dhe c, dhe neni 12, pika 1 dhe 2, të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinonet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**